URDHËR
Nr. 6, datë 19.1.2021

PËR HARTIMIN DHE MIRATIMIN E KËRKESAVE SPECIFIKE PËR ARSIMIMIN E INSPEKTORËVE NË INSPEKTORATET SHTETËRORE/VENDORE DHE STRUKTURAT E TJERA INSPEKTUESE

Në zbatim të germës "f", të pikës 2, të nenit 16, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Inspektorati Qendror, miraton kërkesat specifike për arsimimin e inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore.

Me qëllim formimin profesional të inspektorëve shtetërorë/vendorë për hartimin dhe miratimin e kërkesave specifike për arsimimin e inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore, si dhe inspektorëve të strukturave të tjera përgjegjëse inspektuese;

URDHËROJ:

1. Hartimin e kërkesave specifike për arsimimin e inspektorëve shtetërorë/vendorë dhe strukturave të tjera përgjegjëse të inspektimit, sipas fushave të tyre inspektuese.
2. Përfaqësuesit e inspektorateve shtetërore/vendore, si dhe strukturat e tjera përgjegjëse inspektuese, duhet të hartojnë kërkesat specifike për arsimimin për çdo fushë inspektimi, duke bashkëpunuar me Inspektoratin Qendror.
3. Inspektorati Qendror, pas hartimit të kërkesave specifike për arsimimin e inspektorëve shtetërorë/vendorë, nga çdo inspektorat shtetëror/vendor apo strukturë përgjegjëse e inspektimit, bën miratimin e kërkesave specifike për arsimimin e inspektorëve dhe i publikon ato në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror, në adresën: www.insq.gov.al.
4. Ngarkohen Inspektorati Qendror, inspektoratet shtetërore/vendore, si dhe strukturat e tjera përgjegjëse për inspektimin, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Hajdari